

Summer 7-2020

## VILË BANIMI “MODERN HOUSE”

Driton Berisha

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

---

### Recommended Citation

Berisha, Driton, "VILË BANIMI “MODERN HOUSE”" (2020). *Theses and Dissertations*. 1766.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1766>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

**VILË BANIMI “MODERN HOUSE”**  
Shkalla Bachelor

Driton Berisha

Korrik / 2020  
Prishtinë



Bartës Privat i Arsimit të Lartë  
KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

Punim Diplome  
Viti akademik 2014– 2015

**VILË BANIMI “MODERN HOUSE”**

Mentori: Prof.Dr.Blerta Vula

Qershor / 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të  
pjeshme për Shkallën Bachelor

## **ABSTRAKTI**

Vilat si objekte individuale familjare të banimit janë ndër ndërtesat arkitektonike që kanë pësuar më së shumti ndryshime kuptimore, strukturale, kulturore, si në qasjen kontekstuale ashtu edhe në atë ambientale. Në këtë kuptim edhe termi “Vila” është përdorur në mënyra të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Influencat e ndryshme gjatë historisë kanë bërë që shumë nga karakteristikat e vilave të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, megjithatë disa karakteristika të tyre të lashta akoma ruhen në disa regjione.

Vilat mishërojnë konceptin e Shtëpisë si ambient familjar ku banimi, pushimi, rekreimi dhe sensacioni ndërthohen së bashku në kualitete më të larta të banimit si pjesë e peizazhit natyror. Edhe pse, sot, Vilat kanë marrë më shumë kuptimin e ndërtesave të vendosura në lokacione për pushim, ato prezantojnë më shumë se shtëpitë e zakonshme, ngaqë ato përpos pushimit sezonal krijojnë domethënien e vatrës familjare të rrënjësuar në shpirtin e vendit.

Projekti i vilës “Modern House” i plotëson të gjitha kërkesat dhe nevojat e banorëve për një jetesë mjaft luksoze, vila përveq kthinave elementare të banimit posedon edhe zyre për punë apo kthina për reaksione të ndryshme. Lokacioni i vilës është përzgjedhur në bazë të disa kushteve që nevojiten për projektimin e vilës që tek lokacioni i jonë i përzgjedhur kemi kushte shumë të mira natyrore, privatësi mjaft të lartë si dhe qasje të mirë. Kjo vilë është projektuar për një familje mesatare apo prej 5 personave.

Si karakteristik kryesore tek vila “Modern House” janë hapjet e mëdha që na japin njëlidhje të objektit me natyrën.

## **FALENDERIMET**

Sipas Xhon Djuj “Edukimi nuk është përgaditje për jetë; edukimi është vet jeta”, andaj dhe suksesi nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e juaj të nderuar profesor e profesoresha si dhe përkrahjen e juaj familja dhe shoqëria ime. Ju faleminderit për mundin e juaj të pareshtur, diturinë që më mësuat dhe rëndësinë e edukimit që ju më dhuroat, ju që më lejuat të përjetoj përfundimin e një pjese të edukimit siç është studimi bachelor.

Kurse, Nelsen Mandeles ka thënë “Arsimi është arma më e fuqishme që mund ta përdorësh, për të ndryshuar botën”, dhe këtë armë ma mundësuat ju.

Ky punim ju dedikohet juve që të shikoni rezultatet e arsimit tim të cilin e arrita fal angazhimit të juaj.

Ju falemderoj të gjithëve që kontribuat në arritjen e përfundimit të studimeve.